



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 49 prot.

Kamëz, më 25. 5.2026

V E N D I M
Nr. 42. Datë 25/ 5 2026
MBI

**“ EMËRTIMIN E AMFITEATRIT TEK LIQENI I PASKUQANIT NË TERRITORIN E
BASHKISË KAMËZ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.05.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.38 Datë 22.05.2026 në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar; Vendimit nr. 3430 prot., datë 27.03.2026 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të Bashkisë Kamëz”; Urdhrit nr. 262, datë 19.03.2024 “Për ngritjen e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave mbi emërtimin e bulevardëve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve të territorit nën juridiksionin e Bashkisë Kamëz”, si dhe bazuar në relacionin e paraqitur nga Lagjja Administrative nr. 2 dhe propozimin e Komisionit të Posaçëm për emërtimin e ambienteve sportive në juridiksionin e Bashkisë Kamëz, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e emërimit të Amfiteatrit tek Liqeni i Paskuqanit, me emrin **“Sherif Dervishi”**.
2. Ky emërtim bëhet në nderim të artistit të shquar Sherif Dervishi, një artist i madh i muzikës popullore shqiptare.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtorja e Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit, pranë Bashkisë Kamëz.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

